

**Fjala e Zëvendëskryeminstres së Republikës së Shqipërisë zj Senida Mesi,
në Konferencën e Bankës së Shqipërisë “Modernizimi i sistemeve të pagesave
me vlerë të vogël në Shqipëri”**

Përshëndetje të gjithëve,

I nderuar z. Guvernator,

E nderuar zj. Zëvendësguvernatore,

Të nderuar pjesëmarrës, panelistë dhe folës,

Falënderoj Guvernatorin dhe në veçanti Zëvendësguvernatoren Gjoni për ftesën për të qenë pjesë e një konference të tillë. I falënderoj për këtë ftesë pasi mendoj që jemi në sinkron me Strategjinë e Zhvillimit të Sistemit të Pagesave me Vlerë të Vogël dhe me çfarë qeveria shqiptare po bën për një nga prioritetet e saj, atë të reformimit të shërbimeve në administratën publike, por jo vetëm.

Natyrisht që vendet e zhvilluara kanë arritur një transformim shumë të ndjeshëm në sistemin bankar dhe tregun e sistemeve të pagesave me vlerë të vogël, por Shqipëria nuk është, le të themi, shumë pas tyre. E vlerësoj si tepër të rëndësishme çështjen e modernizimit të sistemit të pagesave me vlerë të vogël, pasi jetojmë në një vend që po avancon shumë shpejt në lidhje me teknologjinë e komunikimit dhe informacionit. Konferenca dhe diskutime të tilla, ashtu si dhe ndryshime në projektligje, gjykoj se janë tepër të rëndësishme.

Besoj fort se, falë edhe pjesëmarrjes së Bashkimit Evropian dhe bankave përfaqësuese të rajonit, shkëmbimi i eksperiencave do të na japë dhe ne si qeveri, por natyrisht edhe Bankës së Shqipërisë, eksperiencën e mjaftueshme për të ecur përpara në përmirësimin, dixhitalizimin dhe inovacionin e sistemeve të pagesave.

Në veçanti, dua të vlerësoj punën e Komitetit Kombëtar të Sistemit të Pagesave, me bindjen se është platforma e duhur për të diskutuar në mënyrë teknike mbi ecurinë e sistemit të pagesave me vlerë të vogël, duke shprehur mbështetjen dhe inkurajimin tim personal, por edhe të qeverisë që përfaqësoj, për realizimin e objektivave të vendosur.

Mbledhja së bashku e shumë aktorëve - sektori privat, sektori publik, institucione të pavarura dhe kompani me përvojë në sistemin e pagesave - i jep një vlerë të shtuar këtij diskutimi.

Qeveria shqiptare, sikurse dhe e përmenda, ka një nga prioritetet e saj, pikërisht përmirësimin e shërbimeve në administratën publike, dhe që nga muaji tetor i vitit 2017 ka intensifikuar ndjeshëm çdo përpjekje për të rinovuar dhe dixhitalizuar shërbimet, duke përfshirë dhe pagesat e mundshme online.

Reforma fokusohet në tre drejtime kryesore: (i) integrimi dhe standardizimi i shërbimeve; (ii) drejt shtimi dhe transparenca e shërbimeve elektronike; si dhe (iii) lehtësimi i procedurave dhe burokracive, quajtur ndryshe procesi i derregullimit.

Përmirësimi i shërbimeve dhe standardizimi i tyre, kalimi në shërbime online, sikurse dhe vetë procesi i derregullimit, janë të gjitha procese të vazhdueshme e në përmirësim të përhershëm, që në mendimin tim, nuk përfundojnë asnjëherë. Megjithatë, kjo nuk na ka penguar që të ecim përpara me objektivat tonë.

Aktualisht, mbi 240 institucione shtetërore bashkëpunojnë në një platformë qeveritare elektronike. Kemi mbi 570 shërbime elektronike që përbëjnë thajse 1/3 e shërbimeve që ofrohen në nivel qeverisjeje qendrore. Mbi 770 shërbime, janë shërbime informative që gjenden në dy platforma – në platformën e-Albania dhe në platformën ADISA.

33 shërbime ofrohen aktualisht me vulë dixhitale, çka do të thotë që janë shërbime fundore, që çdo sipërmarrës apo qytetar mund t'i aksesojë në portalin e-Albania. Përveç kësaj ekzistojnë plot 13 shërbime të ofruara nëpërmjet sistemit të Drejtorisë së Tatimeve, mund të ofrohen jo thjesht online, por dhe nëpërmjet sistemit e-pagesa, ku përfshihen: pagesa mbi vlerën e shtuar; pagesa mbi tatim-fitimin; apo pagesa të ndryshme të kontributeve shoqërore.

Të gjitha këto - bashkohem këtu dhe me parafolësit - sigurisht kërkojnë që ne të edukojmë përherë e më tepër konsumatorët, në rastin konkret, qytetarët dhe sipërmarrësit, klientët e çdo niveli bankar, institucionet bankare dhe jobankare, me qëllim që këto shërbime jo vetëm të aksesohen, por dhe të përdoren në mënyrën e duhur.

Paralelisht, për këtë qëllim ndërtojmë dy platforma komunikimi dhe ndërgjegjësimi për qytetarët. Platforma e parë është karta e qytetarit, e cila do formalizohet dhe ligjërisht për t'i ofruar çdo qytetari të drejtat dhe detyrimet, dhe më shumë informacion në lidhje me çfarë duhet të presë nga institucionet publike, për sa i përket shërbimeve. Ndërsa platforma tjetër është kodi i etikës apo i sjelljes për të gjithë punonjësit e administratës publike, të cilët tashmë, me inovacionin, teknologjinë e informacionit e të komunikimit, si dhe me dixhitalizimin, kanë përherë më tepër akses, jo vetëm në të dhënat e konsumatorëve, qytetarëve dhe sipërmarrësve, por duke ofruar një gamë të gjerë shërbimesh duhet të jenë jo vetëm të përgjegjshëm dhe në përputhje me ligjin, por edhe të zbatojnë kodet e etikës. Njëkohësisht, po punohet për ndërtimin e një manuali standard për çdo zyrë që ofron shërbime publike.

Besoj që të gjitha këto së bashku, dixhitalizimi i shërbimeve, sistemet online, si p.sh.: e-pagesa, e-leje, e-shëndeti, e-prona, do të përmirësojnë jo thjesht shërbimet që qeveria shqiptare ofron për qytetarët, por edhe klimën e biznesit.

Sikurse edhe ju keni parashikuar në Strategjinë Afatmesme të Sistemeve të Pagesave me Vlerë të Vogël, besoj që ekzistojnë disa pika për të cilat mund të bashkëpunojmë, të tilla si: harmonizimi i kuadrit ligjor në sistemin e pagesave me vlerë të vogël në kuadër të direktivave të Bashkimit Evropian; nxitja dhe zhvillimi i mëtejshëm i pagesave online për detyrimet e të gjitha institucioneve shtetërore për mes e-pagesave, si shembujt e sipërpërmendur; dhe nxitja e përdorimit të të gjithë instrumenteve të pagesave.

Kam besim të plotë se bashkëpunimi midis dy sektorëve, privat dhe publik, në këtë drejtim, ka një rëndësi të veçantë për të realizuar objektivat si dhe për të pasur rezultate sa më të mira. Ashtu siç kemi kaluar marrjen e kërkesës së disa dokumentacioneve nga qytetari apo sipërmarrësi tek administrata publike, paralelisht po punojmë dhe me Bankën e Shqipërisë dhe me Shoqatën Shqiptare të Bankave që në sistemin e-Albania t'i japim akses dhe institucioneve private të mirërregulluara, siç janë dhe bankat tregtare dhe institucionet financiare jobanka, në mënyrë që ato të mund të gjenerojnë automatikisht dokumente të tipit të vërtetimit apo ekstrakteve të QKR-së, sigurisht me mirëkuptimin dhe pranimin e klientëve. Dokumente këto që, gjatë punës së përditshme, bankat shpesh herë ia kërkojnë klientëve, me qëllim procesimin e hapjes së llogarive të lëvrimit apo disbursimit, etj.

I inkurajoj të gjithë operatorët e sistemeve të pagesave, institucionet financiare banka dhe ato jobanka, të bashkëpunojnë përmes këtyre platformave inovative të dixhitalizimit, sigurisht nën koordinimin e Bankës së Shqipërisë, të cilën e vlerësoj për rolin e saj. Falë koordinimit, mbikëqyrjes dhe kontrollit të saj, kemi një sistem kaq të konsoliduar bankar e financiar që, nëpërmjet dhe platformave qeverisëse online, aty ku na lejon ligji – ndërsa aty ku nuk na lejon ligji, të rishikojmë kuadrin ku duhet të përmirësohet struktura ligjore - ne t'i koordinojmë këto platforma, me qëllim përmirësimin e sistemit të pagesave, lehtësimin uljen e kostove, rritjen e transparencës etj.

Sigurisht që në afatgjatë, të gjitha këto, në një farë mënyre, bëjnë që të përmirësohet dhe cilësia e jetës së qytetarëve dhe sipërmarrësve. Unë ju uroj punime të mbara gjatë kësaj konference, me rezultate konkrete dhe me bashkëpunim të frytshëm reciprok.

Faleminderit!